

**AKT THEMELIMI**  
**I SHOQËRISË TREGTARE**

**“IDE-AL” Shpk**

Në bazë të Ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” dhe Ligjit Nr.9273 datë 03.07.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, më datë 18.10.2021 u krijua Shoqëria Tregtare “IDE-AL” Shpk, me Ortakë shtetasit: 1. Zj. Sabrije Hamdi Tafili e datëlindjes 25.09.1960, lindur në Manskuri, Durrës dhe banues në Shkallnur, Durrës, shtetas shqiptar e identifikuar me ID, G05925148N , 2. Z. Denis Hilmi Tafili i datëlindjes 20.06.1985, lindur në Durrës dhe banues në Shkallnur, Durrës, shtetas shqiptar i identifikuar me ID, I50620107J dhe 3. Z. Eljon Hilmi Tafili i datëlindjes 03.03.1989, lindur në Durrës dhe banues në Shkallnur, Durrës, shtetas shqiptar i identifikuar me ID, I90303082V e cila do të funksionojë në bazë të këtij, AKT-THEMELIMI.

**LLOJI DHE EMRI SHOQËRISË**

**NENI 1**

Lloji i Shoqërisë Tregtare është Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar dhe emri i saj është “IDE-AL” Shpk

**SELIA E SHOQËRISË**

**NENI 2**

Zyra Qëndrore e Shoqërisë Tregtare “IDE-AL” Shpk, e ka vendodhjen e saj në, Zona Kadastrale 3385, Numri i Pasurisë 215/9, Volumi 26, Faqe 233, Kati 1, Shkallnur, Durrës.

**REGJIMI JURIDIK**

**NENI 3**

Shoqëria është shqiptare e me përgjegjësi të kufizuar.  
Shoqëria fiton personalitetin juridik që në momentin që ajo regjistrohet pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

**OBJEKTI I VEPRIMTARISË**

**NENI 4**

Objekt i Shoqërisë Tregtare “IDE-AL” Shpk është :  
Import-eksport i mallrave të ndryshëm ushqimorë dhe industrialë si dhe tregtimi me shumicë dhe pakice i tyre. Bar-Kafe. Veprimtari në fushën e transportit, magazinimit, përpunimit, prodhimit e tregtimit me shumicë e pakicë, import e eksport, brenda e jashtë vendit i mallrave të të gjitha llojeve, ushqimore e industrial, prodhime bujqësore e blegtorale, fruta-perime e pije freskuese e

alkoolike, materiale e lëndë ndërtimi, pajisje e makineri, elektroshtepiake, hidrosanitare, elektrike e hidraulike, dyqane reklamash, shërbime postare etj.

## KOHËZGJATJA

### NENI 5

Shoqëria Tregtare "IDE-AL" Shpk, do të kryej veprimtarinë dhe aktivitetin e saj për një periudhe kohore të papërcaktuar.

Ajo mund të shpërbëhet në çdo kohë dhe për çfarëdo lloj shkak.

## KAPITALI I SHOQËRISË

### NENI 6

Kapitali Themeltar i regjistruar i Shoqërise Tregtare "IDE-AL" Shpk, përbehet prej 300.000 ( treqindëmijë) lekë.

Pjesmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme :

1. Zj. Sabrije Hamdi Tafili: Zotëruese 1 ( një) e kuote me vlerë të përgjithshme që përbën 33% të kapitalit themeltar të shoqërisë e barabarte me 99.000 leke
2. Z. Denis Hilmi Tafili: Zotërues 1 ( një) e kuote me vlerë të përgjithshme që përbën 33% të kapitalit themeltar të shoqërisë e barabarte me 99.000 leke
3. Z. Eljon Hilmi Tafili: Zotërues 1 ( një) e kuote me vlerë të përgjithshme që përbën 34% të kapitalit themeltar të shoqërisë e barabarte me 102.000 leke

## ADMINISTRIMI

### NENI 7

Administrator i Shoqërisë i emëruar nga Asambleja e Ortakëve është Z. Eljon Hilmi Tafili me një afat 5 vjet me të drejtë rizgjedhje.

## TË DREJTAT E SHOQËRISË

### NENI 8

Shoqëria ka të drejtë të lidh kontrata dhe te nënshkruaj marrëveshje Brenda dhe jashtë vendit.



Shoqëria përgjigjet ndaj të treteve vetëm dhe ekskluzivisht me kapitalin e derdhur.  
Shoqëria përballon humbjet vetëm dhe deri në kufirin e vlerës së kontributit të Kapitalit  
Themeltar.

## VITI FINANCIAR-EKSPERTËT

### NENI 9

Viti financiar i shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përfundimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qëndren Kombëtare të Biznesit dhe përfundon me 31 Dhjetor.

## SHPËRNDARJA E FITIMIT

### NENI 10

Fitimi që do të shpërndahet përbëhet nga fitimi i vitit financiar të cilit i janë zbritur shumat e lëna mënjanë për rezervën sipas ligjit dhe nga ana tjetër janë zbritur ose janë shtuar respektivisht humbjet apo fitimet e mbartura nga vitet e mëparshme.

Ky fitim shpërndahet midis Ortakëve të Shoqërisë sipas kontributit të kuotave në kapitalin themeltar të shoqërisë.

## LIKUJDIMI

### NENI 11

Në këtë rast Ortakët marrin vendim me shkrim në të cilën parashikojnë mënyrën e likujdimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likujdatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likujdatorit dhe emërtesën shtesë "shoqëri në likujdim e sipër".

Likujdimi kryhet nga likujduesit e emëruar nga Ortakët.

Aktin e themelimit e lexuam dhe e gjetëm konform vullnetit tonë dhe e nënshkruajmë pa verejtje.

## ORTAKËT

### E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

"IDE-AL" SHPK

Sabrije Hamdi Tafili

Denis Hilmi Tafili

Eljon Hilmi Tafili

Sabrije Tafili  
Denis Tafili  
Eljon Tafili

DURRES, 24.11.2021